

# Transformatorët e KEK-ut, në duar të amatorëve

Firmës "Remonti" nga Elbasani, sipas dokumenteve që ka "Lajm", KEK-u ia ka ndërprerë punët për riparimin e transformatorëve, ndonëse ajo kishte kontratë valide të lidhur me AKM-në. Ndërsa i është dhënë tenderi firmës "Aulona", e cila sipas dokumentacioneve nuk i plotëson kushtet. Kjo është bërë me nënshkrimin e Fllanza Hoxhës, ndërsa kompania është nga Gjakova

YLLI KALOSHI  
**Prishtinë, 16 qershor** - Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje në një tender për riparimin e transformatorëve, duke ia bërë të padrejtë një firmë nga Shqipëria dhe duke ia dhënë tenderin një firme tjetër, e cila thuhet se nuk i plotëson kushtet e parapara.  
**Firmës "Remonti" nga Elbasani, sipas dokumenteve që ka "Lajm", KEK-u ia ka pamundësuar punën për riparimin e transformatorëve, ndonëse ajo kishte kontratë valide të lidhur me AKM-në.**  
 Në dhjetor 2005, KEK-u ka nënshkruar kontratë me "Remontin" për riparimin e transformatorëve që dëmtohen gjatë punës në KEK, ndërsa vetëm një muaj më vonë zyrtarët e KEK-ut ia ndalojnë punën kësaj firme, pa dhënë shpjegime zyrtare se për çfarë arsyesh ndodh kjo.  
 "17 transformatorë ishin të ngarkuar në kamion për tu dërguar në Elbasan për riparime, kur papritur urdhërohet që të zbarkohen ata nga kamionët dhe të kthehen përfaqësuesit e firmës mbirapshtë". Burime të "Lajmit" thonë se urdhri ka qenë i drejtoreshës së rrethit, Fllanza Hoxhë. Remonti në këtë kohë ka pasur kontratë valide, të vazhduar në dhjetor 2005 nga AKM-ja. Ajo ka punuar

në KEK qysh pas luftës, fillimisht e angazhuar pa ndonjë procedurë tenderuese, më pas në vitin 2003, sipas dokumentacioneve, ka fituar tenderin dhe pati nënshkruar kontratë në vlerë diku rreth 4 milionë euro, e cila skadon në fund të 2005. Por iu vazhdua më pas. Zyrtarë të lartë në AKM thanë se nënshkrimi i aneks-kontratës ka qenë përgjegjësi e kësaj agjencie, e cila, sipas tyre, ka kryer punët kontraktuese për KEK-un deri në fund të 2005. "Por pas kësaj kohe, çështjet tenderuese e kontraktuese kanë kaluar në përgjegjësi të vetë KEK-ut", thanë zyrtarët.  
 Por në KEK japin të dhëna të tjera nga ato të AKM-së. Sipas tyre, përgjegjësitë rreth kontratës me Remontin janë bartur në KEK me vonesë. Zyrtarët në KEK, përmes zëdhënësës Donika Kadaj-Bujupi, thanë se me të marrë përgjegjësinë kanë shpallur tender diku në janar për këtë çështje dhe kanë kontraktuar firmë të re për këtë qëllim.  
**Hoxha, sipas dokumenteve, ia ka ndërprerë punën "Remontit" me arsyetimin se nuk është e certifikuar për riparimin e transformatorëve me certifikatë ISO 9001. Ndërsa burime në KEK thanë se Remonti ka pasur kontratë të**

vazhduar deri në mars 2006. Kurse rreth ndërprerjes së punëve qysh në janar, ata thanë se kjo është bërë për shkak se KEK-u s'e ka parë të arsyeshme të bëjë riparime në atë kohë.  
 Firma e zgjedhur tani për riparime është Aulona. Zëdhënësja Bujupi thotë se firma "Aulona" është zgjedhur me tender, me vlerë të madhe, me procedurë të hapur". Por në KEK nuk tregohet vlera e tenderit, as procedura e ndjekur, ndërsa nuk tregohet as çfarë kushtesh janë kërkuar në tenderin e ri dhe cilat prej tyre i plotëson "Aulona". "Aulona me dokumentacionin e konkurimit i ka plotësuar kushte për dhënien e kontratës", thotë ajo, por në KEK nuk japin dëshmi për këto çështje.  
 "Të gjitha kushtet për dhënien e kontratës janë të cekura në dosjen e tenderit". Sipas saj, në këtë tender një ndër kriteret ka qenë çmimi më i ulët. Sipas dokumentacioneve, kjo firmë është nga Gjakova dhe ishte pjesë e tenderit edhe në 2003. Por, të dhënat në "Lajm" tregojnë se ajo nuk i plotëson kushtet as për së afërmi "Remontit" të Elbasanit. "Kontraktori i ri që i riparoi këta transformator (firma Aulona) jo që nuk e ka këtë standard, por as kushtet minimale që duhet të ketë një Remont".

## më shpejt operatorin e dytë

**Prishtinë, 16 qershor** - Kompania e shpallur fituese për licencën e dytë të telefonisë mobile, Mobikos, e cila më pas u anulua nga UNMIK-u, ka kërkuar që të mos zvarritet tenderi i ri dhe kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt.  
 "Mobikos me keqardhje konstaton se pas dy vjet e gjysmë zgjatjeje të tenderit të telefonisë mobile, vendi ende ndodhet pa konkurrencë në këtë lëmi dhe është populata ajo e cila nuk ka mundësi të zgjedhë operator alternativ. Mobikos, pas shpalljes fitues në tenderin e kaluar dhe pas anulimit të të njëjtit nga PSPP-ja me përkrahje të Qeverisë aktuale, bën thirrje që së paku të përshpejtohet procedura e tenderit të ri të telefonisë së dytë mobile në Kosovë", ka deklaruar Fatmir Gashi, drejtor i kësaj kompanie, përmes një komunikate për media.  
 Sipas tij, Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka theksuar se zhvillimi ekonomik është një nga prioritetet e saj.  
 "Përshpejtimi i procesit për shpalljen e tenderit për operatorin e dytë të telefonisë mobile ofron një shembull të këtij përkushtimi duke pasur parasysh ndikimin që do të kishte një operator të dytë në zhvillimin e ekonomisë kosovare. Hapja e vendeve të reja të punës dhe ofrimi i një shërbimi më të mirë dhe më të lirë për qytetarët e Kosovës, si dhe efekti në liberalizimin e tregut, janë disa nga shembujt që një përshpejtim i këtij procesi do të ofronte", ka thënë ai.  
 Një përfitim tjetër, sipas komunikatës, do të ishte fakti që operatorit i dytë do të ofronte përshpejtimin e këtij procesi dhe tërheqjen e investitorëve dhe kompanive të huaja për partneritete me kompanitë kosovare në këtë projekt kaq të madh e të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë së vendit.

